



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.897/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë Arsim Selimi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli Anr.897/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidati për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë Arsim Selimi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet vetëm për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në Qendrën e Votimit 1927E/02R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e apelit të për vendvotimet 1927E/06R, 1927E/07R, 1927E/08R, 1927E/09R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë Arsim Selimi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se ka fakte të pamohueshme se votat e ti janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e nje dëshmitari i cili ka qene edhe Kordinator i qendrës se votimit 1927E/02R, si dhe disa formular ne te cilët pretendon se ka ndodhur manipulimi. Duke qenë i

bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në Qendrat e Votimit 1927E/02R, 1927E/06R, 1927E/07R, 1927E/08R, 1927E/09R. të dërgohen në rinumërim për shkak se vota e mikut të ti në këte qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i saj është dëmtuar. PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Kandidatit për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë Arsim Selimi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Qendrën e Votimit 1927E/02R, 1927E/06R, 1927E/07R, 1927E/08R, 1927E/09R.

Paneli vlerëson se apeli është pjesërisht i bazuar vetëm sa i përket vendvotimit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidati Arsim Selimi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku shihet se nga deklaratat e gjithsej nje votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarin se në vendvotimin 1927E/02R, e ka votuar kandidatin Gjithsej vota në këto vendvotime kanë rezultuar 0 derisa nga deklaratat e dëshmitarëve ishte dashur të jenë se paku 1 vot.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuse si ne piken IV te dispozitivit me te cilën refuzohet si ne piken IV e pa bazuar ankesa për vendvotimin 1927E/06R, 1927E/07R, 1927E/08R, 1927E/09R. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluesi që ishin Formularët e përrputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga të cilat formularë rezultoi se kandidati për anëtarë të Kuvend Komunal në Komunën e Prishtines Arsim Selimi nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, pasi qe ne vendvotimet e apeluara i njëjti nuk ka marur as nje vote e jo me shume se sa pretendon.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.897/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit

Ferki Xhaferi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.

